

VENDIM
Nr. 710, datë 20.11.2024

PËR BAZËN E TË DHËNAVE SHETËTËRORE “SISTEMI I MENAXHIMIT TË INFORMACIONIT E-AKTET”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e rregullave për bazën e të dhënave shtetërore “Sistemi i menaxhimit të informacionit *e-aktet*” (në vijim, “*e-aktet*”).

2. *E-aktet* ka si qëllim ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të dhënave në formë elektronike për projektaktet dhe dokumentet shoqëruese *on-line* të institucioneve shtetërore, duke i grupuar sipas linjës hierarkike të miratimit të tyre, në zbatim të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të vendimit nr. 584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar.

3. Institucioni administrues i bazës së të dhënave shtetërore *e-aktet* është Këshilli i Ministrave.

4. Lista e institucioneve dhe e organeve në sistemin *e-aktet* përbëhet nga ministritë dhe ministrat e shtetit, sipas përbërjes së Këshillit të Ministrave, si dhe institucionet e varësisë së tij. Lista e institucioneve të varësisë në sistemin *e-aktet* përcaktohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, në varësi të shkallës së përfshirjes që ato kanë për dhënien e mendimit për projektaktet. Funksionet e punonjësve në këtë sistem përcaktohen sipas detyrave që ata ushtrojnë gjatë procesit të hartimit, bashkërendimit, dhënies së mendimit apo shqyrtimit të projektaktit, sipas legjislacionit për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave.

5. Në *e-aktet* regjistrohen nëpunës dhe titullarë të institucioneve propozuese dhe mendimdhënëse për projektaktet ligjore e nënligjore, sipas pikës 4, të këtij vendimi.

6. Të dhënat që përmban *e-aktet* ndahen në të dhëna parësore e dytësore.

7. Të dhëna parësore konsiderohen të dhënat e mëposhtme:

- a) Plani vjetor analitik i projekteve për vitin pasardhës;
- b) Kodi identifikues i projektaktit;
- c) Emërtimi i projektaktit;
- ç) Dokumente bazë të projektaktit (projektakti, anekse, protokolle, shtojca, formularë etj.);
- d) Dokumente shoqëruese (relacion, komunikatë, harta etj.);
- dh) Kërkesa për mendim e titullarit të institucionit, e firmosur elektronikisht;
- e) Përgjigjja e kërkesës për mendim e firmosur elektronikisht;
- ë) Numër protokollit dalës/hyrës;
- f) Statusi i projektaktit;
- g) Kodi identifikues i mbledhjes së Këshillit të Ministrave;
- gj) Statusi i mbledhjes së Këshillit të Ministrave;
- h) Rendi i ditës i mbledhjes së Këshillit të Ministrave;
- i) Statusi i rendit të ditës të mbledhjes së Këshillit të Ministrave.

8. Të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat që merren nga një bazë tjetër të dhënash, ku ato janë parësore, që mund të ndërveprojë me *e-aktet*, në përputhje me parashikimet e legjislacionit për bazat e të dhënave shtetërore.

9. Dhënës të informacionit për *e-aktet* janë institucionet propozuese dhe mendimdhënëse, në zbatim të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të vendimit nr. 584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar.

10. Niveli i aksesit në *e-aktet* është, si më poshtë vijon:

a) Këshilli i Ministrave ka të drejta të plota administrative mbi bazën e të dhënave në rolin:

i. “Administrator i bazës së të dhënave”.

b) Përdoruesi i autorizuar nga institucionet propozuese/mendimdhënëse dhe Këshilli i Ministrave:

i. Koordinator iniciues, që fillon procedurën për projektaktin;

ii. Punonjësit, që kryejnë në sistem procedurat e hartimit, përgatitjes dhe miratimit së brendshmi të projektaktit apo të mendimit për të, në aparatin e ministrisë apo të institucionit të varësisë;

iii. Sekretar i Përgjithshëm institucioni, që miraton;

iv. Titullari i institucionit, që dërgon për mendim ose për miratim në Këshillin e Ministrave dhe kthen përgjigje;

v. Përdorues, vetëm lexues pranë Kryeministrit, ministrit të Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Kodifikimit);

vi. Koordinator institucioni mendimdhënës;

vii. Protokolli/arkivi;

viii. Jurist në Kryeministri;

ix. Redaktor;

x. Drejtori i strukturës/ave përgjegjëse për aktet, në Kryeministri;

xi. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, zëvendësi i tij ose punonjësi, të cilit i janë deleguar kompetencat e tij.

11. Secila etapë e procedurave të lidhura me projektaktin apo dhënien e mendimit për të përmbyllet nga punonjësi përgjegjës në ministri, sipas funksionit të tij, duke shoqëruar veprimin e tij në sistem me nënshkrimin elektronik.

12. Sistemi garanton në çdo rast ruajtjen e historikut të gjendjes së projektaktit dhe praktikës shoqëruese të tij, në momentin kohor të dhënë, të çdo etape procedurale.

13. Të gjitha ndërveprimet e ministrive dhe të institucioneve të varësisë në *e-aktet*, ndërmjet tyre apo me Këshillin e Ministrave, për dërgimin e projektaktit për mendim apo për shqyrtim regjistrohen në sistem nëpërmjet numrit të protokollit, i cili korrespondon me atë në variantin *hard copy*.

14. Kryeministri miraton rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave *e-aktet*, në përputhje me rregullat e parashikuara në ligjin nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe vendimin nr. 584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, të ndryshuar.

15. Dokumentet e krijuara dhe/ose të ngarkuara në sistemin elektronik të *e-aktet*, që prej fillimit të funksionimit të këtij sistemi, konsiderohen pjesë e dokumentacionit të projektaktit. Ky rregull zbatohet për të gjitha dokumentet, që janë ngarkuar në këtë sistem nga organet kompetente, sipas legjislacionit për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave, duke përfshirë dokumentet elektronike, që përmbajnë nënshkrimin elektronik apo vulën elektronike, dokumentet e tjera në format elektronik, që nuk i përmbajnë këto elemente, si dhe dokumentet që ngarkohen si kopje e një dokumenti shkresor *hard copy* të vlefshëm, të krijuar jashtë sistemit. Këto dokumente, në rast nevojë të arkivimit dhe/ose të shpërndarjes e shfrytëzimit në format shkresor *hard copy* nga të tretë, pas printimit shoqërohen me vulën e institucionit ose me elemente të tjera teknologjike të autentifikimit, si: *barcode*, kode QR etj.

16. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për të hartuar rregulloren e parashikuar në pikën 14 të këtij vendimi dhe për t’ia paraqitur atë për miratim Kryeministrit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku